

URDHËR
Nr. 13, datë 18.1.2018

**PËR NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR PËRGATITJEN
E NDRYSHIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR PËRMIRËSIMIN E PUNËS ME
DOKUMENTET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e ndryshimeve të legjislacionit për përmirësimin e punës me dokumentet në Republikën e Shqipërisë.

2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Drejtorin e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit;
- Drejtorin e Arkivit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Drejtorin e Qendrës së Botimeve Zyrtare;
- Përfaqësuesin e Ministrisë së Brendshme.

Në përbërje të grupit të punës ftohet të marrë pjesë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ose përfaqësuesi i tij.

3. Grupi ndërinstitucional i punës mund të ftojë në mbledhjet e tij dhe të konsultohet me ekspertë të fushës, brenda dhe jashtë vendit.

4. Grupi ndërinstitucional i punës të identifikojë legjislacionin rregullator për punën me dokumentet, që kanë nevojë të ndryshohet, dhe pas konsultimit me praktikant ndërkombëtar të legjislacionit analog, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, të përgatitë dhe të paraqesë nismat ligjore për ndryshimet përkatëse.

5. Ngarkohen kryetari e anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës dhe institucionet që ata përfaqësojnë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama